

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË**  
**“FRASSAF” sh.p.k**

Ne mbështetje të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 “*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*”, vendosa hartimin e këtij Akti Themelimi, me kushtet që përcaktohen si më poshtë:

Sot në datë 06.11.2023, ortakët e shoqërisë:

1. ASSAF ALMOUBAYED, i datëlindjes 20.11.1989 shtetas Libanez, lindur në Beyrouth me pasaport me nr. LR1115284 ;
2. FRANCK ONTENIENTE, i datëlindjes 02.04.1993 shtetas Francez, lindur në Paris me pasaport me nr. 13DD800099.

me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, të shprehur nëpërmjet këtij akti themelimi, vendosi për krijimin e shoqërisë tregtare “FRASSAF” sh.p.k., me kushtet e mëposhtme:

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Ky akt rregullon pozitën juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e partneritetit, kohëzgjatjen e veprimeve të saj, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi që rregullon marrëdhëniet juridiko-civile.

**Neni 1**  
**EMËRTIMI**

Shoqëria Tregtare themelohet si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar sh.p.k. dhe do të ketë Emërtimin “FRASSAF” sh.p.k.

**Neni 2**  
**FORMA JURIDIKE**

Shoqëria Tregtare “FRASSAF” Shpk, themelohet si Shoqëri Tregtare me Përgjegjësi të Kufizuar sh.p.k. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqipëtar. Shoqëria krijohet në bazë të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ku në nenin 3 përcaktohet se:

*“1. Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomike të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).*

*2. Shoqëritë tregtare duhet të regjistrohen sipas nenit 22 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, si dhe neneve në vijim, sipas formës përkatëse të shoqërisë tregtare.*

*3. Shoqëritë tregtare fitojnë personalitetin juridik në datën kur kryhet regjistrimi i tyre në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëritë përgjigjen me të gjitha aktivet e tyre për detyrimet, që rrjedhin nga veprimtaritë e ushtruara.”*



**Neni 3**  
**KOHËZGJATJA**

Shoqëria "FRASSAF" sh.p.k do të ushtrojë aktivitetin e saj tregtar sipas objektit të veprimtarisë për një afat kohor të pakufizuar.

**Neni 4**  
**SELIA**

Shoqëria "FRASSAF" sh.p.k., e ka selinë në adresën Rruga "Reshat Osmani", Pallati "Albatros 2", kati 1, hyrja 1, Vlorë.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.

**Neni 5**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Investimin në pasuri të paluajtshme, shitblerje pronash, dhënie/marrje pronash me qira, dhënie pronash me qira ditore dhe shërbimet me Airbnb;
- Ndërmjetësim dhe konsulencë për prona të patundshme në të gjithë Republikën e Shqipërisë dhe ndërmjetësim punësimi i burimeve njerezore.
- Kryerjen e shërbimeve të operatorit turistik, kryerjen, ofrimin dhe drejtimin e shërbimeve dhe sipërmarrjeve turistike, realizimin e projekteve dhe veprimtarive të të gjitha llojeve në përputhje me legjislacionin shqipëtar, në lidhje dhe në dobi të bashkëpunimit, në fushën e turizmit, tregtisë, biznesit, telekomunikacionit, mbrojtjes së mjedisit dhe investimit mjedisor në përputhje me legjislacionin shqiptar që lidhet me fushën e mjedisit.
- Hartimin e programeve dhe projekteve në lidhje me menaxhimin, konsultimin e bizneseve të ndryshme, investimeve dhe lidhjen e marrëveshjeve dhe bashkëpunimit me subjekte të ndryshme si persona fizik, juridik, organizata jofitimprurëse etj.
- Krijimin e agjencive turistike në të gjithë territorin Republikës së Shqipërisë, në organizimin e udhëtimeve ose të pushimeve individuale e kolektive; shërbimet që mund të ofrohen në rastin e udhëtimeve dhe pushimeve, si rezervimi i vendeve në mjetet e transportit të udhëtarëve, marrja dhe vënia në dispozicion me qira totale ose pjesërisht e keqytire mjeteve të transportit, rezervimi i dhomave në hotelet turistike, porositja e të ngrënit në restorantet turistike, dorëzimi i bonove të rezervimit dhe të porositjes në mjetet e transportit, hotele dhe restorante; në shërbimet e lidhura me pritjen turistike, si organizimi i vizitave në qytete, muze, monumente etj, shërbimi i guidëpërkthyesve, shoqëruesve; në dhënie e informacioneve për udhëtime e turizëm. Këto shërbime mund të kryhen të grupuara ose individuale, të programuara paraprakisht ose sipas dëshirës së klienteve. Shërbime hotelerie dhe transport turistik, në drejtimin dhe administrimin e bar-restoranteve dhe hoteleve të të tretëve apo të vetë shoqërisë. Organizimi i udhëtimeve për turistët me mjete të të tretëve apo të vetë Shoqërisë. Aktivitete dhe investime në fushën e turizmit, hapje hotelesh, bar kafe, restorante. Shoqëria do të ketë si objekt veprimtarie edhe menaxhimin e objekteve të dhëna me qira.
- Krijimi i agjensive të marketingut, menaxhim i rrjeteve sociale, ëeb desing, marketing i permbajtjes, shërbime kerkimi, konsulence, materiale promociionale, produkte krijuese, organizim eventesh, organizime trajnimesh, trajnime, workshops, shërbime grafike, shërbime audio-vizuale, video produksion, shërbime marketing, planifikime marketing, trajnime biznesi, konsulence biznesi, etj. Eksport shërbimesh, media online, portal lajmesh, blog online, qeradhenie të materialeve të produksionit si kamera, ndriçim etj, krijimi i reklamave të ndryshme dhe spoteve;





- Hapje dhe shrytezim hotelesh, bar-kafe, restorantesh, resorte, diskotekash. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike .
- Hapje e qendrave të pushimit, qendra kurative, fitness, aktiviteteve sportive dhe argëtuese për të gjitha grupmoshat, ambiente relaksi dhe shërbimesh të kujdesit ndaj vetes;
- Krijimi i linjave dhe shërbimeve të internetit dhe venien e shërbimit të tij për të tretët.
- Importimi dhe eksportimi i artikujve të ndryshëm.

### Neni 6 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues me vlerën **100,000 lekë** dhe përbëhet nga 2 (dy) kuota, ku secili prej ortakëve ka një kuotë:

- **ASSAF ALMOUBAYED një kuotë me vlerë 50%** e kapitalit.
- **FRANCK ONTENIENTE një kuotë me vlerë 50%** e kapitalit.

### Neni 7 TRANSFERIMI I KUOTAVE

Kuotat e kapitalit janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakëve, si dhe midis njerit prej ortakëve dhe të tretëve.

Ortaku që kërkon të shesë kuotën e tij një personi tjetër, duhet detyrimisht t'u bëjë njoftim ortakëve të tjerë të shoqërisë, duke u njohur e drejta e parablerjes për ortakët sipas ligjit.

Kur disa ortakë ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes dhe shprehin dëshirën e tyre për të blerë kuotën, ortaku shites gezon të drejtën diskrecionale për të zgjedhur se cilit ortak ai dëshiron të shesë totalisht ose pjesërisht kuotat e tij. Ortaket duhet të përgjigjen brenda 30 ditëve nëse dëshirojnë të blejnë kuotat e ofruara apo jo.

### Neni 8 SHPËRNDARJA E FITIMIT

Ortakët financojnë, përfitojnë rimbursim të financimit të tyre dhe ndajnë fitimin e tyre në bazë të kuotave në kapitalin themeltar.

### Neni 9 ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet e shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Zakonshme ose e Jashtëzakonshme e Ortakëve
2. Administratori.




Administratori i shoqërisë do të jetë z. ASSAF ALMOUBAYED, i datëlindjes 20.11.1989 shtetas Libanez, lindur në Beyrouth me pasaport me nr. LR1115284, i cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë rriemërimi.

#### Neni 10

#### KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

1. Administratori ushtron këto kompetenca në emër të Shoqërisë:
  - a) Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) Të përfaqësojë shoqërinë tregtare me të tretët;
  - c) Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) Të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) Të kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - g) Të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h) Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
2. Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e asamblesë së ortakëve edhe në rastet kur:
  - sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
  - shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
3. Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaja, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht, ortakëve të shoqërisë.
4. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

#### Neni 11

#### VITI FINANCIAR



Veprimtaria ekonomike dhe financjare e shoqerise ndahet ne perjudha financiare 12 mujore. Viti financiare fillon nga data 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti kalendarik, me perjashtim te vitit te pare i cili fillon nga data e krijimit te shoqerise dhe mbaron me 31 Dhjetor.

## **Neni 12 EKSPERTËT**

Shoqeria mban dokumentacionin e nevojshem financiar per administrimin e pasurise dhe per zhvillimin e te gjitha veprimtarise se saj, ne perputhje me kerkesat e te gjitha legjislacionit perkates ne fuqi.

Bilanci financiar i shoqerise perpilohet ne baze te raportit me shkrim te eksperteve kontabel te autorizuar dhe te raportit te paraqitur nga administratoret brenda dates 31 mars te vitit pasardhes. Te dy raportet paraqiten me miratohen ne asamblene e ortakeve brenda dates 30 qershor.

Fitimi neto i shoqerise llogaritet mbasi zbriten humbjet e mundshme te vitit te meparshem, shlyerja e te gjitha detyrimeve fiskale dhe ndaj cdo personi te trete, si dhe fondet financiare qe perbejne rezerven e detyrueshem.

## **Neni 13 ZGJIDHJA E MOSMARRREVESHJEVE**

Mosmarrveshjet lidhur me themelimin dhe zhvillimin e veprimtarise se shoqerise zgjidhen nga vete ortaket e shoqerise me mirekuptim, dhe kur kjo nuk arrihet ato zgjidhen nga gjykata ne territorin e se ciles ndodhet selia e shoqerise.

Ky Akt Themelimi u hartua në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën Shqipe.

### **ORTAKET E SHOQËRISË “FRASSAF” Sh.P.K**

**ORTAK  
ASSAF ALMOUBAYED**

Assaf AlMoubayed  


**ORTAK  
FRANCK ONTENIENTE**

Franck ONTENIENTE  
